

Dëshmorëve të Luftës në Pllaqicë/Pločica.

Burimet: deklarata H.M, FDH-33620; deklarata V.B, FDH-8879; deklarata B.M, FDH-36015; ICTY, IT-05-87 (Milutinović dhe të tjerë), EX.6D00700, FDH-33284; *Foreign Reporter on Another Serb Atrocity in Malisheva Villages Last Weekend*, pasqyra e lajmeve, KIC, 30.09.1998, FDH-33992; *Bodies of Six Killed Albanians Found near Pllaqica Village on Tuesday*, pasqyra e lajmeve, KIC, 07.10.1998, FDH-29726.

Ahmet (Xhemajl) Maloku

(14.04.1944, shqiptar nga Pllaqica/Pločica, komuna e Malishevës/Mališevo, punëtor, nëntë fëmijë)

Ajet (Milazim) Maloku

(10.02.1949, shqiptar nga Pllaqica/Pločica, komuna e Malishevës/Mališevo, tregtar, tetë fëmijë)

Aziz (Haxhi) Maloku

(23.04.1949, shqiptar nga Pllaqica/Pločica, komuna e Malishevës/Mališevo, pensionist, shtatë fëmijë)

Fazli (Halil) Hoxha

(15.05.1949, shqiptar nga Golluboci/Golubovac, komuna e Malishevës/Mališevo, punëtor, nëntë fëmijë)

Mehdi (Sylë) Morina

(25.02.1952, shqiptar nga Arllati/Orlate, komuna e Glllogocit/Glogovac, punëtor, gjashtë fëmijë)

Zeqir (Shaban) Berisha

(1.11.1954, shqiptar nga Gjurgjeviku i Madh/Veliki Đurdevik, komuna e Klinës/Klina, bujk, katër fëmijë)

Remzi (Sokol) Veseli

(27.09.1957, shqiptar nga Gllareva/Iglarevo, komuna e Klinës/Klina, punëtor në fabrikën e municionit, katër fëmijë)

Rasim (Izet) Maloku

(6.04.1959, shqiptar nga Pllaqica/Pločica, komuna e Malishevës/Mališevo, profesor, tre fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Halim (Izet) Maloku

(1.11.1960, shqiptar nga Pllaqica/Pločica, komuna e Malishevës/Mališevo, mësues, dy fëmijë)

Muhamet (Halil) Maloku

(30.07.1961, shqiptar nga Pllaqica/Pločica,

komuna e Malishevës/Mališevo, tregtar, tre fëmijë)

Selman (Xhemë) Deligashi

(1.06.1967, shqiptar nga Pllaqica/Pločica, komuna e Malishevës/Mališevo, punëtor, pjesëtar i UÇK-së)

Bedri (Fazli) Gashi

(12.04.1969, shqiptar nga Balinca/Balince, komuna e Malishevës/Mališevo, punëtor)

Osman (Fetah) Morina

(23.03.1973, shqiptar nga Golluboci/Golubovac, komuna e Malishevës/Mališevo, punëtor)

Gjatë verës së vitit 1998, në Golluboc/Golubovac u strehuan shqiptarët nga fshatrat Gllarevë/Iglarevo, Cerrovikë/Cerovik, Ballincë/Balince, si dhe nga fshatrat e tjera përreth. Në mëngjesin e datës 25.09.1998, ushtria e nisi bombardimin e Gollubocit/Golubovac, nga drejtimi i fshatrave Cerrovikë/Cerovik, Mleqan/Mleçane dhe Kijevë/Kijevo. Banorët dhe refugjatët, të cilët ishin strehuar në Golluboc/Golubovac, u zhvendosën në pyll që gjendet në mes të fshatrave Golluboc/Golubovac dhe Pllaqicë/Pločica. Aty më herët kishin arritur rreth dy mijë persona, të zhvendosur nga Pllaqica/Pločica. Pjesëtarët e UÇK-së u rezistonin forcave serbe nga fshati [Golluboc/Golubovac]. Policia serbe ishte pozicionuar te varrezat lokale, nga ku qëllonte me armë zjarri mbi shtëpitë.

Një ditë më vonë, më **26.09.1998**, herët në mëngjes, policët dhe ushtarët serb e zbuluan turmën e njerëzve në pyll dhe e rrethuan atë. U urdhëruan të gjithëve që të mblihdeshin në vendin e quajtur *Livadhet e Hajdinëve/Livade Hajdinijevih*. Pastaj, i ndanë burrat nga gratë dhe fëmijët. Burrave të moshuar u lejuan që me gratë dhe fëmijët të braktisnin pyllin. I ndalën me vete 14 burra: Ahmetin, Ajetin, Azizin, Muhame-tin, vëllezërit Rasim dhe Halim Malokun, Zeqir Berishën, Selmanin, Osman dhe Mehdi Morinën, Bedri Gashin, Fazli Hoxhën, Remzi Veselin dhe Selman Deligashin. I morën me vete deri te shkolla fillore në **Golluboc/Golubovac**, duke i rrahur tërë rrugës me kondakët. Pastaj, i quan te shtë-